

**Njoftim për përqendrim me të cilin Arena Channels Group SHPK Beograd, Serbi do të fitoj kontrollin mbi Arena sport SHPK Lubjanë Slloveni**

**(lënda nr. 08-131/2023)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 30.08. 2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Arena Channels Group SHPK Beograd, me seli në rr. Vladimir Popoviq nr.6 Beograd i ri- Beograd, Republika e Serbisë do të fitoj kontrollin mbi Arena sport SHPK Lubjanë, me seli në rr. Shlandrova nr.4B, Lubjanë -Çrnuçe, Republika e Sllovenisë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:**

**Arena Channels Group SHPK Beograd** është një transmetues i kanaleve televizive sportive në kanalet e saj të specializuara televizive sportive (Arena Sport), si dhe në kanalet televizive me përmbajtje filmike dhe seriale.

Palë e ndërlidhur e parashtruesit të njoftimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut është shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup me seli në rr. Maksim Gorki 11/1-3 Shkup, i regjistruar për veprimtarinë e telekomunikacionit me tela, gjegjësisht për ofrimin e shërbimeve në vijim: rrjet publik radio-komunikues, akses në internet me brez të gjerë, shërbime ndër-operatore, shërbimet telefonike të disponueshme publikisht në një rrjet publik komunikimi celular, ritransmetim i shërbimeve programore televizive, satelitore.

**Arena sport SHPK Lubjanë** prodhon dhe transmeton një program televiziv sportiv tematik.

parashtruesi i njoftimit konsideron se për qëllime të vlerësimit e përqendrimit, si treg relevant mund të përkufizohet tregu i prodhimit dhe transmetimit të kanaleve televizive sportive.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

18.09.2023

Shkup